



KËSHILLI BASHKIAK

V E N D I M

Nr. 32, datë 05.04.2016

PËR “MIRATIMIN E NIVELIT TË PAGAVE TË PUNONJËSVE TË BASHKISË SË TIRANËS”

Në mbështetje të nenit 8 pika 2, nenit 9, pika 1.1, shkronja “b”, nenit 54 shkronja “ç”, nenit 55, pika 2, të Ligjit nr. 139/2015, datë 17.12.2015 për “Vetëqeverisjen vendore”; Ligjit nr.152/2013, datë 30.05.2013 “Për nëpunësin civil” (i ndryshuar); nenit 113 të Ligjit nr. 44/2015, datë 30.4.2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”; Ligjit nr.9936, datë 26.06.2008 për “Menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” (i ndryshuar); nenit 2, shkronja “c” dhe nenit 5 të Ligjit nr.10405, datë 24.3.2011 për “Kompetencat për caktimin e pagave dhe të shpërblimeve”; Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.165, datë 02.03.2016 për “Grupimin e njësive të vetëqeverisjes vendore, për efekt page, dhe caktimin e kufijve të pagave të funksionarëve të zgjedhur e të emëruar, të nëpunësve civilë e të punonjësve administrativë të njësive të vetëqeverisjes vendore” (i ndryshuar); dhe vendimit të Këshillit Bashkiak të Tiranës nr.84, datë 29.12.2016, “Për miratimin e programit buxhetor afatmesëm 2017-2019 dhe detajimin e buxhetit të Bashkisë së Tiranës për vitin 2017” (i ndryshuar), me propozimin e Kryetarit të Bashkisë, Këshilli Bashkiak;

V E N D O S I:

1. Miratimin e nivelit të pagave për funksionarët, nëpunësit civilë, punonjësit administrativë të Bashkisë së Tiranës si dhe punonjësit e Policisë Bashkiake sipas lidhjeve nr.1, 2 dhe 3 bashkëlidhur këtij vendimi.
2. Efektet financiare të këtij vendimi fillojnë më 1 Mars të vitit 2017 dhe do të përballohen nga buxheti i Aparatit të Bashkisë së Tiranës për vitin 2017.
3. Për zbatimin e këtij vendimi, ngarkohen Drejtoria e Përgjithshme e Burimeve Njerëzore, Drejtoria e Përgjithshme e Menaxhimit Financiar dhe Drejtoria e Financës.
4. Vendimi i Këshillit Bashkiak nr.30, datë 23.05.2016 për “Miratimin e nivelit të pagave të punonjësve të Bashkisë së Tiranës”, shfuqizohet..
5. Ky vendim hyn në fuqi sipas parashikimeve të pikës 6 të nenit 55, të ligjit 139/2015, datë 17.12.2015 për “Vetëqeverisjen Vendore” dhe pas konfirmimit nga Institucioni i Prefektit të Qarkut Tiranë.

K R Y E T A R

ALDRIN DALIPI

Lidhja nr. 1 – Niveli i pagës për funksionarët dhe nëpunësit civilë në Bashkinë e Tiranës

E M Ë R T I M I	Kategoria	Grupi	Paga e grupit	Vjetërsia në %	Shtesa për pozicion
Kryetar i Bashkisë	—	—	—	—	174 760
Zv/Kryetar i Bashkisë	—	—	—	—	140 000
Administrator i Përgjithshëm	I	b	1	2%	129 800
Drejtor i Kabinetit	II	a	1	2%	118 100
Sekretar i Këshillit Bashkiak	II	a	1	2%	118 100
Drejtor i Përgjithshëm	II	a	1	2%	118 100
Këshilltar në Kabinet	II	b	1	2%	100 000
Drejtor Drejtorie	II	b	1	2%	100 000
Përgjegjës Sektori	III	a	1	2%	80 800
Përgjegjës Sektori	III	a/1	1	2%	70 500
Përgjegjës Zyre	III	b	1ose 2	2%	61 000
Specialist I	III	b	1ose 2	2%	61 000
Specialist II	IV	a	1ose 2ose 3	2%	49 000
Specialist III	IV	b	1ose 2ose 3	2%	38 000
Sekretar i kryetarit	IV	a	1ose 2ose 3	2%	49 000

Lidhja nr. 2 – Niveli i pagës për punonjësit administrativ

Nr	Emërtimi	Klasa	Paga Bazë	Shtesa për vjetërsi ne %
1	Specialist me arsim te mesëm (kontrata), Sekretare	V	39 000	1%
2	Magaznier	IV	39 000	1%
3	Punonjës shërbimi, Receptionist	III	37 000	1%
4	Shofer	II	35 000	1%
5	Pastruese	I	32 000	1%

1.Shtesa për vjetërsi në punë për Lidhjen nr. 2 të jepet në masën 1% pas çdo viti pune, deri në 25 vjet, dhe të llogaritet mbi pagën baze të klasës së I.

Lidhja nr. 3 – Niveli i pagës për punonjësit e Policisë Bashkiake

Nr	Emërtimi	Paga
1	Kryeinspektor i Policisë Bashkiake të Tiranës	97 300
2	Inspektor i Policisë Bashkiake të Tiranës	76 500
3	Punonjës i Policisë Bashkiake të Tiranës	58 850

